



Npi – 01/135 datë: 03.04.2025

Duke u bazuar në nenin 12.2 shkronja (d) dhe nenin 17 shkronja (o) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.28/2008); Nenin 7, 8, 10 të Ligjit për Sistemin e Adresave në Republikën e Kosovës Nr.04/L-071; Statutin e Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Kuvendi i Komunës së Shtimes pasi analizoi listën e Kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve Npi – 01/45 datë: 12.02.2025, dhe duke marrë parasysh edhe Rekomandimin e Komisionit Npi-01/60 të datës 13.03.2025, si dhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa Npi-01/118 të datës 01.04.2025, Kuvendi i Komunës në seancën e mbajtur më 03.04.2025 miratoi këtë:

V E N D I M

PËR REFUZIMIN E KËRKESËS TË BEKIM SEFERI

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e -III- të rregullt për vitin 2025, të mbajtur më: 03.04.2025, me shumicën e votave vendosi të REFUZOJË Kërkesën Nr:06-350/02-4783/25 datë 27.02.2025, Të Bekim Seferi nga Lagja e Pajtimit, për emërtimin e një Segmenti të rrugës "Anton Çeta" në dalje të Shtimes me emrin "Muhamet Seferi".

II

K ë r k e s a: z.Bekim Seferi – Lagje e Pajtimit, Kërkesa Nr:06-350/02-4783/25 datë 27.02.2025, ka kërkuar emërtimin e një Segmenti të rrugës "Anton Çeta" në dalje të Shtimes me emrin "Muhamet Seferi". Si arsyetim ka dhënë faktin se i ndjeri Muhamet Seferi ka qenë një kohë të gjatë Sekretar i Xhamisë së madhe në Shtime dhe ka luajtur rol të rëndësishëm në aktivitetet shoqërore dhe fetare. Po ashtu ka qenë i angazhuar në shumë aksione humanitare dhe e ka ndihmuar komunitetin me ndihma në momentet më të vështira. Ka kontribuar në ruajtjen e traditave dhe forcimin e bashkëpunimit mes njerëzve. Ishte figurë e respektueshme për të gjithë. Ky segment ka vetëm tri shtëpi dhe që të trija këto shtëpi janë djem, nipa e mbesa të Haxhi Muhametit.

III


- A r s y e t i m: Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në komunën e Shtimes, me rekomandimin Npi-01/60, pas grumbullimit të informatave, në mbledhjen e mbajtur më më 18.12.2024, unanimisht vendosi që ti Rekomandon Kuvendit, Refuzimin e Kërkesës Nr:06-350/02-4783/25 datë 27.02.2025 të Bekim Seferit nga Lagja e Pajtimit për emërtimin e një Segmenti të rrugës "Anton Çeta" me emrin "Muhamet Seferi".
- Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më 01.04.2025 miratoi Rekomandimin, Npi – 01/118, me të cilin Kuvendit të Komunës i Rekomandon Refuzimin e kësaj kërkesë.
- Duke marrë parasysh të gjitha këto Kuvendi mori vendim sikurse në Dispozitiv.

IV

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi